



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 96

Ora: 16:55

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 59, DATË 11.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KRYETARI I BASHKISË KUKËS Z. SAFET GJICI

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Safet Gjici

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 440, datë 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi



Rrethanat e çështjes:

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me nr. 336 ID me denoncues qendra "Qëndresa Qytetare". Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike nga ana e z. Safet Gjici, kryetari aktual i bashkisë Kukës dhe kandidat për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka konstatuar shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.
2. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe ndaj z. Rustem Dervishi, Drejtor i Shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati" në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.
3. Kryetari i bashkisë Kukës z. Safet Gjici ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 59 regj., datë 11.05.2023. Në këtë kërkesë ankimore, z. Safet Gjici kundërshton vendimin nr. 440, datë 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke kërkuar shfuqizimin e saj si të pabazuar në prova dhe ligj.
4. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ledio Braho si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 11.05.2023, ora 16:15. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Pala ankimuese, e njoftuar rregullisht nuk u paraqit në seancë.
5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 59, datë 11.05.2023;
 - Kërkesën nr. 20, datë 06.05.2023 të Komisionerit;
 - Vendimin nr. 440, datë 05.05.2023 të Komisionerit "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 336 ID të Organizatës "Qëndresa Qytetare", ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati" Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023".

- Vendimin nr. 85, datë 08.05.2023 të KAS-it, "Për shqyrtimin e kërkesave nr. 19 dhe nr. 20, datë 06.05.2023" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

KAS-i konstaton:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 440, datë 05.05.2023, si hap procedural përmbyllës për hetimin administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Kukës z. Safet Gjici. Bazuar në nenin 21 pika 1 shkronja "dh" të K.Zgjedhor që parashikon se "1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca: ... dh) me kërkesë të Komisionerit vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka proceduar me kërkesën e tij nr. 20, datë 06.05.2023 për vënie sanksioni administrativ, gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë ndaj z. Safet Gjici dhe 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë ndaj z. Rustem Dervishi, Drejtor i Shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati". Vendimi nr. 440, datë 05.05.2023 shpreh vetëm vullnetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën për marrjen e masës administrative me gjobë. Ky vendim nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe nuk cënon asnjë interes të palëve të prekura, sepse kompetenca për vendosje sanksioni administrativ është kompetencë e KAS-it. Të drejtat e palëve të prekura, në rastet e procedimit me kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbrohen vetëm duke marrë pjesë si palë në shqyrtimin administrativ që zhvillohet nga KAS-i, dhe jo me procedurë ankimore ndaj vendimit përmbyllës të Komisionerit.
2. KAS-i ka marrë në shqyrtim kërkesën nr. 20 , datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe me vendimin nr. 85, datë 08.05.2023 ka vendosur marrjen e masës administrative, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për z. Safet Gjici, sipas nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Në seancën e shqyrtimit administrativ, ankuesi z. Safet Gjici nuk ka marrë pjesë edhe pse ka qenë i njoftuar për zhvillimin e saj.
3. Pas daljes të vendimit të KAS-it nr. 85, datë 08.05.2023, KAS-i e ka ezauruar kompetencën e tij vendimmarrëse dhe ankuesi e ka humbur të drejtën për të vënë në lëvizje KAS-in. Nga ky moment kompetenca i kalon Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe ankuesi mund të mbrojtë të

drejtat dhe interesat e tij të ligjshme, duke iu drejtuar me padi Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në përputhje me nenin 145 të Kodit Zgjedhor.

4. Për sa më sipër, kjo kërkesë ankimore nuk plotëson dy nga elementet e parashikuar në nenin 130 të K.Zgjedhor, më konkretisht *“kompetencën e KAS për shqyrtimin e ankimit”* dhe *“legjitimitetin e ankuesit”* pasi ai nuk mund të ankohet ndaj vendimit të Komisionerit objekt i këtij ankimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 59, datë 11.05.2023 të depozituar nga z. Safet Gjici.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Ledio BRAHO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar